



NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEGA NË SUHAREKË, Gjyqtari Qemail Suka, me pjesëmarrjen e Sek. Juridike Vjollca Bytyqi, në lëndën penale sipas P.Th. nga Prizreni, aktakuzës PP.II.nr.133-4/20 të datës 26.02.2020, ndaj të pandehurit F. T. nga D. Komuna Suhareke, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 pika 1.4 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në prezencë të prokurorit të PTH-së, nga Prizreni Shpend Binaj dhe të akuzuarit, në seancën e shqyrtimit fillestar, të mbajtur me dt. 23.12.2020 mori, publikisht shpalli dhe me date 03.02.2020 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari F. T. nga i ati A. e ëma V. e Lindur R. i lindur më 19.02.1994 nga fsh. D. e Komuna Suharekë, ku dhe tani jeton, beqar, ka të kryer shkollën e mesme i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 18.01.2020, rreth orës 13:30 minuta në Suharekë, afër kafiterisë "R.", i shkakton lëndime trupore dhe përkohësisht ia dëmton shëndetin e të dëmtuarit P. M., në atë mënyrë që deri sa i dëmtuari ishte i ulur në lokal të bashku me motrën e tij K. dhe shoqen e saj B., i pandehuri pandërprerë i shikonte dhe i fyente vajzat, i pandehuri largohet nga lokali, pas pak del edhe i dëmtuari me shoqërueset e tij dhe momentin kur tenton të hyjë në automjetin e njëjti goditet nga i pandehuri me grusht në pjesën e qafës, kokës dhe dorës ku me ç' rast me këto veprime i shkakton lëndime të lehta trupore dhe atë gërvishtje lëkurore të regjionit të qafës, fytyrës dhe dy parakrahëve të duarve, lëndime këto më afër të konstatuara në mendimin e ekspertit mjeko-ligjor, Dr. F. D., të dhënë me dt. 30.01.2020.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 pika 1.4 të KPRK së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 38, 39, 40, 43, 69, 70 KP-së si dhe 365 të KPP-së, i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Ne shumë prej dyqind (200) €, të cilin dënim duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari dënimin në të holla nuk e paguan në afatin e parapare, gjykata dënimin me gjobë do të ia zëvendësoi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 ditësh, duke e llogaritur me nga 20 € për çdo ditë burgimi.

Obligohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën prej 30 euro, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 euro, të gjitha këto pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Udhëzohet pala e dëmtuar P. S. M. nga fsh. V. komuna Suhareke, që kërkesën pasurore-juridike, ta realizoj në kontest të rregullt civil

A r s y e t i m

PTH-e me aktakuze aktakuzës PP.II.nr.133-4/20 të datës 26.02.2020, ndaj të pandehurit F. T. nga D. Komuna Suhareke, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale lëndimi i lehte trupor nga neni 185 par. 1 pika 1.4 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, te cilin gjatë seancës se shqyrtimit fillestar e ka përfaqësuar PTH nga Prizreni Shpend Binaj, i cili ne tërësi ngel pranë te dhënave si ne aktakuzë, qe i akuzuari te shpallet fajtor dhe te dënohet sipas ligjit.

Gjykata ne shqyrtimin e sotëm dhe me vet pranimin nga ana e te akuzuarit ka vërtetuar këtë gjendje faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vet pranimi i te akuzuarit i cili ne shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 257 te KPP-së ne shkresat e lendes nuk ka gjetur ndonjë prove te pa pranueshme dhe po ashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajësisë, pranimi i fajit nga ana e te akuzuarit, është bere vullnetarisht ne shqyrtimin fillestar, pranimi është mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban aktakuza, te cilat gjinden ne shkresat e lendes si dhe provat materiale te paraqitura ndaj te akuzuarit nga ana e PTH-ës ne Prizren.

Gjykata po ashtu ne tërësi ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë ne shqyrtimin fillestar nga ana e te akuzuarit, është bërë ne pajtim me dispozitat e nenit 248 te KPP-ës, nga se nuk ekziston ndonjë nga arsyet dhe kushtet për hedhjen e propozimit akuzës, apo pushimin e procedurës penale.

Nga këto fakte te cilat i përmban aktakuza, Gjykata ka ardhur ne përfundim se me veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale lëndimi i lehte trupor nga neni 185 par. 1 pika 1.4 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, andaj Gjykata ka vendosur se akuzuari është fajtor dhe i shqiptoi dënim me gjobë ne shume prej 200 euro, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse në afatin e verifikimit prej një viti i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KP-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethana rënduese, si rrethanë lehtësuese gjykata vlerësoi se i njëjti është i pa dënuar më parë, pranimin e fajësisë, rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarit, moshën e të akuzuarit, bashkëpunimin e përgjithshëm të të akuzuarit me gjykatën, andaj gjykata i shqiptoi dënim me gjobë prej 200 €, me bindje se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe të përmbahet nga veprimet e tilla apo të ngjashme. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike e mori ne kuptim te nenit 463 te KPP-së. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u mori ne kuptim te nenit 452 paragrafi, 1 te KPP-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA SUHAREKË

Gj y q t a r i
Qemail Suka

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtine, përmes kësaj Gjykate.